



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 09 . 01 . 2023

V E N D I M

Nr. 02 , Datë 09 . 01 . 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, mori në shqyrtim ankesën nr. 139, datë 12.09.2022, e Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive, znj. S.L, ku pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” nga ana e Bashkisë Kamëz.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Fillimisht, Fondacioni “Së Bashku” e bën me dije KMD-në se që prej muajit prill 2022, është duke zbatuar nismën “*Të rinjtë për gjithëpërfshirjen*”, në Bashkitë Kamëz, Vorë dhe Kavajë. Qëllimi i këtij projekti është edukimi i të rinjve të Bashkive Kamëz, Vorë dhe Kavajë për aktivizimin dhe diversitetin rinor, me synimin përfundimtar krijimin e një grupi për çdo bashki prej 15 aktivistësh, që mund të sjellin ndryshime konkrete, përmirësimin e gjithëpërfshirjes në shërbimet ekzistuese të bashkive dhe ngritjen e ankesave ndaj bashkive për të garantuar një komunitet gjithëpërfshirës për të rinjtë me dhe pa aftësi të kufizuara.

Në Bashkinë Kamëz është ngritur grupi i të rinjve aktivistë, të cilët nga inspektimi në terren në Bashkinë Kamëz kanë konstatuar disa problematika në ambientin hyrës të Zyrës së Gjendjes Civile, të Bashkisë Kamëz. Pala ankuese ka depozituar në cilësi prove foto të hyrjes së godinës së gjendjes civile të kësaj bashkie dhe pretendohet se rampa nuk plotëson standardet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, pasi është e ngushtë, e rrëshqitshme etj, dhe është i pamundur aksesimi me

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

mjetet ndihmëse të personave me aftësi të kufizuar, duke përfshirë të gjitha kategoritë e tyre, gjë që ka cenuar jetesën e tyre, të pavarur, që nënkupton aksesin fizik të tyre pa ndihmën e personave të tjerë.

Pala ankuese thekson faktin se mbështetur në legjislacionin në fuqi, infrastruktura për ushtrimin e detyrave nga Zyrat e Gjendjes Civile në bashki garantohej nga vetë këto institucione dhe mbështetur në Kreun IV, neni 8, pika 2.11 “Platformat e pjerrëta (rampat)” të Vendimit nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”, ku parashikohet se:

“Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësojë kushtet:

- *pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);*
- *gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendshme;*
- *shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës,*
- *sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse;*
- *rrethim të ndërtuar me dorëza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi;*
- *dorëzë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;*
- *rrethim i rampës, i cili gjendet në hapësirat e jashtme, dorëza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndryshme nga ndryshimet termike ;*
- *rrethim me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm;*
- *përdorim i shenjave të përshtatjes sipas fig. 1.5, 1.7 dhe 1.8 të shtojcës A.*
- *Përcaktimet dhe kushtet e rampave janë paraqitura në figurën 6 të shtojcës B*
- *Pjerrësia e platformave nuk duhet t'i kalojë 8%. Janë të pranueshme pjerrësi më të larta, në rastet e përshtatshmërisë, të lidhura me zhvillimin linear efektiv të platformës”*

Në nenin 5, pika 1 dhe 2, germa f), të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar” përcaktohet se jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevojta, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare. Sipas parashikimit të kësaj dispozite, politikat shtetërore duhet të mbështetin personat me aftësi të kufizuara, që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës, ku ndër të tjera edhe në komunikim dhe informacion.

Në Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për

personat me aftësi të kufizuara” dhe Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*” përcaktohet se në çdo ndërtim publik/privat, të vjetër ose të ri, duhet të merren masat që të garantohen standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e jetesës së pavarur.

Në këto kushte, mbështetur në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Fondacioni “Së Bashku” pretendon se kategoria e personave me aftësi të kufizuara diskriminohen nga Bashkia Kamëz.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Mbështetur në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Në nenin 3, pika 11, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Organizatat me interesa legjitime*” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së Bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cenuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbimin në Zyrën e Gjendjes Civile, pranë Bashkisë Kamëz, pasi rampa e vendosur pranë kësaj zyre nuk plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për personat para-tetraplegjikë.

Mbështetur në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Mbështetur në nenin 7 të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Zyra e Gjendjes Civile Kamëz është strukturë e veçantë brenda strukturës organike të Bashkisë Kamëz. Kjo e fundit, në cilësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore ofron shërbime publike dhe merr pjesë në sektorin publik vendor. Në kuptim të nenit 7, të LMD, të ndryshuar, Bashkia Kamëz është një autoritet publik vendor që ofron shërbime publike, sipas ligjit 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD, të ndryshuar. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 139, datë 12.09.2022, së Fondacionit “Së Bashku”, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Kamëz me shkresën nr. 1238/1 Prot., datë 15.09.2022. Shkresa iu dërgua për dijeni edhe subjektit ankues.

Në prapësimet e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa, KMD kërkoi që të dërgohej informacioni nëse godina ekzistuese e Zyrës së gjendjes Civile pranë Bashkisë Kamëz është e pajisur me rampë, e cila plotëson kriteret e parashikuara në Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*, për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave paraplegjikë-tetraplegjikë.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

- Bashkia Kamëz nuk i ktheu përgjigje shkresës së sipërcituar të KMD-së.
- Në vijim, KMD iu drejtua sërish Bashkisë Kamëz nëpërmjet shkresës nr. 1238/2 prot., datë 03.11.2022, ku i bën kujtesë për kthim përgjigje dhe për të dërguar informacionin e kërkuar me shkresën paraardhëse.
- Bashkia Kamëz dërgoi në adresë të KMD-së shkresën nr. 265/1, datë 15.11.2022, nëpërmjet së cilës informon se Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka kryer verifikimet dhe konstatimet e nevojshme pranë Zyrës së Gjendjes Civile Kamëz dhe po merr të gjitha masat që pajisja me rampa pranë kësaj zyre të përfundojë brenda muajit nëntor 2022. Për sa i përket projektimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme për sigurimin e aksesueshmërisë fizike të personave paraplegjike-tetraplegjikë, Bashkia Kamëz kërkon një kohë pak më të gjatë për zgjidhjen e kësaj problematike, pasi ambienti në të cilin ndodhet kjo zyrë kërkon një projektim të mirë menduar dhe funksional, që të jetë brenda standardeve. Bashkia Kamëz siguron që ky shërbim do të jetë funksional brenda muajit dhjetor 2022.
- Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri vendosi realizimin e seancës dëgjimore në datën 12.12.2022, ora 11:00, ku palët u njoftuan nëpërmjet shkresës nr. 1238/4 Prot., datë 23.11.2022, së KMD-së.

Në seancë dëgjimore morën pjesë përfaqësues të subjektit ankues dhe Bashkisë Kamëz. Përfaqësuesja e Bashkisë Kamëz sqaroi se parashtrimet lidhur me çështjen do t'i paraqiste me shkrim në vijim të seancës dëgjimore, pasi shkresa paraardhëse ishte dërguar nga një strukturë tjetër (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike) e Bashkisë Kamëz.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Bashkia Kamëz dërgoi shkresën nr. 256/3, datë 19.12.2022, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në se *“.....Ju bëjmë me dije se në ambientet hyrëse të Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Kamëz, Ndërmarrja e shërbimeve Publike ka bërë të mundur pajisjen me rampa, të cilat janë realizuar sipas kushteve të ambienteve të jashtme, për të bërë të mundur aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Bashkëngjitur do të gjeni edhe foton që vërteton realizimin e rampave”*.
- Në kushtet kur, shkresa e sipërcituar ishte dërguar për dijeni edhe pranë Fondacionit “Së Bashku”, KMD iu drejtua, nëpërmjet e-mailit zyrtar këtij subjekti, në datën 27.12.2022, duke i kërkuar të kryente verifikimet përkatëse dhe të konfirmonte informacionin e dërguar nga Bashkia Kamëz.
- Nëpërmjet e-mailit të datës 28.12.2022, znj. S.L, Drejtore Ekzekutive e Fondacionit “Së Bashku”, drejtuar Komisionerit, kërkoi tërheqjen nga ankesa nr. 139/2022, pasi është arritur efektiviteti për të cilin, është filluar hetimi administrativ.

Mbështetur në sa më sipër, KMD çmon se:

Mbështetur në nenin 90 “Përfundimi i procedurës administrative”, paragrafi 3, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohej e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.”

Bazuar në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, paragrafi 1, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”, i cili është tërhequr nga ankesa, pasi falë ndërhyrjes në KMD-së, është arritur qëllimi për të cilin kjo OJF kishte depozituar këtë ankesë.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohej e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur qëllimi, për të cilin ai kishte depozituar këtë ankesë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90, pika 3 dhe 94, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenin 32, pika 3, nenin 33 pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 139, datë 12.09.2022, së Fondacionit “Së Bashku”, pa një vendim përfundimtar, pasi subjekti ankues është tërhequr nga ankesa, sepse është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA